

**VENDIM**  
**Nr. 210, datë 7.10.2024**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË  
SHOQËRISË “ORHER” SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E  
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.10.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1958/1 prot., datë 3.10.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Orher’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Orher” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1958 prot., datë 23.9.2024, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 mw, në zonën e Semanit, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të rregullores dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat: “a” “b” dhe “c”; në pikën 1.2, germat: “a”, “c” dhe “d”; në pikën 1.3, germa “a”; në pikën 2.1, germat: “b”, “d”, “e” dhe “f”.

- Rezulton se shoqëria “Orher” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) kontratën nr. 2996 rep., nr. 1957 kol., datë 24.5.2023, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 mw dhe veprave ndihmëse, në zonën e Semanit, në fshatin Povelce, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria ‘Orher’ sh.p.k.”;

- Ka marrë miratimin e pikës së lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet shkresës së “OSSH” sh.a. nr. 2740/3 prot., datë 20.3.2023; Është pajisur me vendim për VNM paraprase, lëshuar më datë 11.4.2023, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin “Impianti Fotovoltaiik Orher, 2 mw”. VNM-ja paraprase e depozituar nga shoqëria është aktualisht e vlefshme (deri më 11.4.2025), por vlerësohet t’i kërkohej asaj të bëjë me dije në rast se ka filluar punimet për ndërtimin e centralit dhe nëse po, t’i dokumentojë ato në ERE.

- Nga ky aplikim nevojitet të plotësohet dhe informacioni/dokumentacioni në vijim:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2

- germa “b”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimet me data të përditësuara.

- germa “c”: Shoqëria duhet të informojë se cila është struktura aktuale organizative e saj, pasi ka depozituar një strukturë bashkëlidhur planit të biznesit dhe një strukturë tjetër më vete.

Pika 1.3.

germa “b”: Shqëria duhet depozitohet në ERE informacion/dokumentacion në rast se ka pasur ndryshime në vlerën e investimit, një dokument të përditësuar nga banka, në lidhje me financimin e projektit, si dhe të sqarohet raportin në përqindje të financimit të projektit, nëse do të realizohet 100% nga banka, apo dhe nga fonde të vetat.

Pika 2. Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

Pika 2.1

- germa “a”: Shqëria duhet të plotësojë kapacitetin e instaluar të secilës prej njësive, dokumentacion teknik mbi jetëgjatësinë e centralit dhe një datë të saktë për fillimin e operimit.

- germa “c”: Shkresa e “OSSH” sh.a. për miratimin e pikës së lidhjes është depozituar në format fotokopje, ndaj do t’i kërkohej shqërisë që ta depozitohet atë në format origjinal ose fotokopje të njësuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shqërisë “Orher” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 mw, në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shqërinë “Orher” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
**Petrît Ahmeti**